



V E N D I M

Nr.1

Datë 04 shkurt 2016

PËR

MIRATIMIN E BORDIT TË PËRBASHKËT TË ZHVILLIMIT RAJONAL TË ZONËS NDËRKUFITARE SHQIPËRI - KOSOVË SI DHE RREGULLOREN E FUNKSIONIMIT

Në mbështetje të Ligjit Nr.10130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit" si dhe në zbatim të Deklaratës së Përbashkët mes Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Kosovës për bashkëpunim në fushën e zhvillimit rajonal në brezin kufitar Shqipëri – Kosovë nënshkruar me 23 mars 2015:

U V E N D O S:

1. Ngritja e Bordit të Përbashkët për Zhvillimin Rajonal të Zonës ndërkufitare Shqipëri - Kosovë.
2. Miratimi i Rregullores së Funkcionimit të Bordit të përbashkët për Zhvillimin Rajonal të Zonës Ndërkufitare Shqipëri - Kosovë sipas tekstit bashkëlidhur këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Benet BECI

Drejtor Ekzekutiv

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Mimoza KUSARI-LILA

Kryetare

Komuna Gjakovë